



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
APELACIONI SUD KOSOVO – COURT OF APPEALS

PA1.nr.1008/22

NË EMËR TË POPULLIT,

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Branka Semenov , kryetare e kolegjit, Ferit Osmani dhe Lidija Vucurovic, – anëtarë kolegjit, më pjesëmarrjen e sekretares juridike Biserka Milenkovic, në lëndën penale kundër të akuzuarit Z.M. , nga fshati “...” Komuna e Kamenicës, për shkak të veprës penale Vjedhja e pyllit nga neni 349 par. 2 KPRK-së duke vendosur përkitazi me ankesën mbrojtësit të akuzuarit - avokatit L.C. nga Kamenica, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan- Dega në Kamenicë P.nr.145/2019, e datës 14.02.2022, mbas seancës e kolegjit të mbajtur më date **09.09.2022**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e mbrojtësit e akuzuarit Z.M. – avokatit L.C. nga Kamenica , ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan –Dega në Kamenicë , P.nr. 145/2019 nga dt. 14.02.2022 **VËRTETOHET**

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e shkallës së parë i akuzuari Z.M. nga fshati “...” Komuna e Kamenicës , është shpallur fajtor për shkak veprës penale Vjedhja e pyllit nga neni 349 par. 2 KPRK. Iu është shqiptuar dënimi me gjobë në shumë nga 300 (treqind) euro të cilin dënim duhet të paguan në afatin nga 10 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi , në të kundërtën e njëjti dënim me gjobë do të zëvendësohet me dënim me burg ashtu se për 20 euro do të llogaritet një ditë në

burg , dhe dënim me burg në kohëzgjatjen nga 4 (katër) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk e kryen një tjetër vepër penale në afatin nga 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit , ndërsa në qoftë se në afatin e ekzaminimit dënimi me kusht mundët të revokohet me dënimin me burg.

Me të njëjtën dënim e dëmtuara J.N. , për shkak realizimit të kërkesës juridiko – pasurore , udhëzohet në kontest civil, e i pandehuri obligohet që në emër të paushallit të gjykatës paguan shumën nga 20 euro , dhe 30 euro për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha në afatin nga 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit , nën kërcenim të përmbarrimit me dhunë.

Kundër aktgjykimit e atakuar ankesën në afatin ligjor ka ushtruar mbrojtësi e të akuzuarit L.C. , avokati nga Kamenica, për shkak vërtetimit e gabuar të gjendjes faktike, me propozimin që Gjykata e Apelit të aprovon ankesën , të ndryshohet aktgjykimi apo lënda të kthehet në rigjykim.

Prokurori i prokurorisë së Apelit me parashtresën e vet PPA/II nr. 1046/2022 nga dt. 20.07.2022 propozoi se ankesa e mbrojtësit të pandehurit të refuzohet si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i atakuar Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë P.nr. 145/2019 nga dt. 14.02.2022 të vërtetohet.

Kolegji i Gjykatës së Apelit të Kosovës mbas shqyrtimit të shkresave të lëndës në tërësi, aktgjykimit e atakuar, pretendimeve ankimore në ankesën e mbrojtësit e të akuzuarit dhe propozimit e Prokurorisë së Apelit ka gjetur se:

Ankesa e mbrojtësit të akuzuarit Z.M. – avokatit L.C. është e pa bazuar.

Duke e shqyrtuar aktgjykimin atakuar në pjesën në të cilën gjykata shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare, Kolegji i kësaj gjykate ka gjetur se aktgjykimi i shkallës së parë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 KPRK –së e as shkeljet të drejtë materiale.

Sipas pikëpamjes së kolegjit të kësaj gjykate , gjykata shkallës së parë drejt ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në ashtu të vërtetuar gjendjen faktike në arsyetimin e aktgjykimit ka dhënë arsytet të qarta, jo kundërthënëse dhe bindëse , të cilat në të gjitha i pranon edhe kjo gjykatë.

Në bazë të provave të administruara, para gjithash deklaratës së dëshmitarëve D.D., M.M., N.A., M.M., B.M., të cilat si të tilla i pranoi si të besueshme, sepse të njëjtat kanë qenë të qarta, bindëse, dhe logjike dhe në pajtim njëra me tjetrën dhe me provat materiale të paraqitura. Gjykata shkallës së parë deklaratën e dëshmitarit D.D. , i cili është kunati i të dëmtuarës J.N. , e pranoi si bindëse dhe të argumentuar.

Po ashtu, gjykata shkallës së parë vlerësoi edhe provat materiale të cilat janë në shkresa të lëndës. Sipas pikëpamjes së kolegjit e kësaj gjykate mbrojtja e të akuzuarit është dhënë pikërisht për shkak shmangies apo uljes së përgjegjësisë penale.

Divizioni i Gjykatës së Apelit ka shqyrtuar aktgjykimin e shkallës së parë në pjesën e vendimit mbi dënim , dhe ka gjetur se ankesa e ushtruar dhe në atë drejtim është e pa bazuar. Prandaj, sipas gjetjes së kolegjit të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë drejt ka vërtetuar dhe në masë të mjaftueshme ka vlerësuar të gjitha fakte apo rrethanat të cilat e kanë rëndësishme për matjen e dënimit në kuptim e nenit 69 dhe 70 të KPRK-së , dhe si rrethanat lehtësuese ka marrë në parasysh se kundër të akuzuarit nuk udhëhiqet ndonjë procedurë tjetër penale, ndërsa gjykata shkallës së parë nuk e ka gjetur rrethanat rënduese për të akuzuarin.

Përkundër pretendimeve në ankesë të mbrojtësit e të akuzuarit të gjitha rrethanat të cekura vërtetojnë drejtshmerinë e gjykatës shkallës së parë në aspektin e gjendjes faktike të vërtetuar dhe vendimit për llojin dhe lartësinë e dënimit të shqiptuar ndaj të pandehurit.

Kolegji i kësaj gjykate konsideron se me dënimin me gjobë nga 300 euro , dhe me dënim me burg nga 4 (katër) muaj, ku njëkohësisht caktohet se e njëjta nuk do të ekzekutohet , ne qoftë se i njëjti nuk e kryen një tjetër vepër penale do të realizonte qëllimi i dënimit të paraparë me nenin 38 në planin e preventivës speciale edhe gjenerale.

Nga të cekurave e në bazë të nenit 398 paragraf 1 nën paragraf 1.1 të KPRK-së është vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimit.

GJYKATA E APELIT TË KOSOVËS
PA1 nr. 1008/22 nga dt. 09.09.2022

Sekretare Juridike,
Biserka Milenkovic

Anëtarë të kolegjit:
1. Ferit Osmani
2. Lidija Vucurovic

Kryetare e kolegjit – gjyqtare
Branka Semenov

Përkthimi: Amira Bajramovic